


Statistikat Tregtare te Kosovës, Tregtia e jashtme e mallrave, eksporti-importi me Serbinë

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) shkëmbimi tregtar me Serbinë¹, për vitin 2025, deficitin tregtar ka shënuar një rritje prej 126.4% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit kaluar, duke arritur në -173.1 milionë euro nga -76.5 milionë euro sa ishte në 2024. Mbulueshmëria e importit nga eksporti ka arritur në 26.2%

Figura 1. Bilanci tregtar i mallrave me Serbinë, sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Tabela 1. Bilanci tregtar i mallrave në milionë euro, në % mbulueshmëria dhe rritje (v-m-v)

Viti	2022	2023	2024	2025
Eksport	62.9	49.6	53.3	61.5
Import	372.1	192.7	129.7	234.6
Bilanci tregtar	(309.2)	(143.0)	(76.5)	(173.1)
% e mbulimit	16.9%	25.8%	41.1%	26.2%
Rritje Exp. (v-m-v) %	43.2%	-21.1%	7.3%	15.5%
Rritje Imp. (v-m-v) %	22.1%	-48.2%	-32.7%	80.9%
Bila. Treg. (v-m-v) %	18.6%	-53.7%	-46.5%	126.4%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)


¹ Serbia, zyrtarisht Republika e Serbisë, është një vend pa dalje në det në Evropën Juglindore dhe Qendrore, me kryeqytet Beogradin. Ka një sipërfaqe prej 77,589 km² me rreth 6.7 milion banor. Bruto Prodhimi Vendor (GDP) Nominal për 2025 vlerësohet rreth 99.9 miliardë \$ (dollar amerikan), me të ardhura për kokë banori (per capita) rreth 15,284 \$ (dollar amerikan).

Gjatë periudhës së fundit katërvjeçare shihet se, eksportet kanë treguar një trend të luhatshëm me rritje në vitet e fundit, duke u rritur nga 53.3 milionë euro në vitin 2024 në 61.5 milionë euro në vitin 2025, ndërsa te importet përsuan një rënie të ndjeshme në vitin 2024 në 129.7 milionë euro (nga 372.1 sa ishte në vitin 2022), por shënuan një rritje të hovshme prej 80.9% në vitin 2025, duke arritur vlerën prej 234.6 milionë euro.

Si rezultat i këtij trendi, deficitin tregtar me Serbinë në vitin 2025 shënoi një rritje prej 126.4% krahasuar me vitin paraprak, duke thelluar deficitin nga -76.5 milionë euro në -173.1 milionë euro.

Rënia e shkallës së mbulimit të importit nga eksporti në 26.2% (nga 41.1% sa ishte në vitin 2024) dëshmon se ekonomia e Kosovës mbetet shumë e varur nga produktet serbe, ndërsa aftësia konkurruese e prodhuesve vendorë për të zëvendësuar këto importe ose për të rritur praninë e tyre jashtë mbetet e kufizuar.

Figura 2. Eksport/Importi me Serbinë sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Pozita gjeografike e Serbisë si shtet fqinj dhe anëtare e CEFTA, e bën një vend të rëndësishëm në raportet tregtare, eksport-importin e mallrave të Kosovës.


Gjatë vitit 2025 vlera e mallrave të eksportuara arrin në 61.5 milionë Euro apo 6.5% si pjesëmarrjen në eksportin e përgjithshëm, renditet e pesta në listën e 10 vendeve kryesore të eksportet.

Importi i mallrave nga Serbia arritën në 234.6 milionë Euro apo 3.3% si pjesëmarrjen në importin e përgjithshëm, renditet e nënta në listën e 10 vendeve kryesore të importet.

Struktura e Eksportit/Importit me Serbinë në 2024 - 2025 sipas Seksioneve-grup kapitujve

Sipas të dhënave nga Open DATA Doganat e Kosovës(DK) për vitin 2025 grupet kryesor të Eksportit e përbëjnë: 29.1% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 17.2% Produkte bimore; 10.4% Produktet Minerale; 10.4% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre; 7.3% Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 5.6% Tekstil dhe artikuj tekstili; 4.5% Artikuj të ndryshëm të prodhuar (mobileri, krevat, dyshek, jastëk etj); 4.2% Druri dhe artikuj druri; 4.1% Artikuj prej guri, allçie, prod. qeramike dhe qelqi, etj. si pjesëmarrjen në eksportin e përgjithshëm me Serbinë.

Figura 3. Struktura e Eksportit 2024-2025 sipas Seksioneve-grup kapitujve në %




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës(DK)

Rritja e eksporteve për 15.5% apo rreth 8.3 milionë euro më shumë mallra të eksportuara në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rritja e sektorëve si Produkte bimore (nga 12.5% në 17.2%), Druri dhe artikuj druri (nga 3.1% në 4.2%), një rritje e lehtë të Tekstil dhe artikuj tekstili (nga 4.7% në 5.6%) etj.

Te Importet për vitin 2025, kemi këtë renditje të sektorëve-grupe kapitujve kryesor si në vijim: 22.6% Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 15.8% Produkte bimore; 10.6% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 9.2% Produkte të industrisë kimike; 7.5% Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe; 5.7% Artikuj prej guri, allçie, prod. qeramike dhe qelqi;

5.6% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre; 4.4% Yndyrëra; 4.3% Letër dhe artikuj prej letre, etj. si pjesëmarrjen në importin e përgjithshëm nga Serbia.

Figura 4. Struktura e Importit 2024 - 2025 sipas Seksioneve-grup kapitujve në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK) dhe OpenDATA Doganat e Kosovës(DK)

Rritja e importeve për 80.9% apo rreth 104.9 milionë euro më shumë mallra te importuara në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rritja e sektorëve si Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani (nga 17.5% në 22.6%), Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe (nga 2.6% në 7.5%), Artikuj prej guri, allçie, prod. qeramike dhe qelqi, (nga 1.7% në 5.7%), etj.